



| | | | |
|-------------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery | 29.12.2021 | viti god year | 1 |
| Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtujca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SPKISHCK | 6344/2021 | | 114 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.918/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-Kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti- anëtarë, dhe Ilire Mehmeti Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.918/2021 të datës 10.11.2021 të parashtruar nga ankuesit

dhe të cilët me autorizim i përfaqës nga kundër organit të punësimit/Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.918/2021 të datës 10.11.2021 të parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe përmes përfaqësueses së autorizuar avokates me datë 10.11.2021 kanë parashtruar ankesën me numër të protokollit 5379/2021 të regjistruar me numër A.nr.918/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes me numër 07 Nr.1196 të datës 20.08.2021 të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Ferizajt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Komunën e Ferizajt. Këshilli me datë 14.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave administroj këto prova: Ankesën A.nr 918/2021 të datës 10.11.2021 me numër të protokollit 5379/2021, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Formularin e datës 26.08.2021; Kërkesën e datës 10.08.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 20.08.2021 me numër 1196; Formularin e datës 11.08.2021; Ankesën e datës 20.08.2021; Listën e pagave për muajin nëntor të vitit 2019; Vërtetimin e datës 23.04.2021 me numër të protokollit 812; Vërtetimin e datës 05.06.2020 me numër të protokollit 773/5; Autorizimin e datës 20.05.2021; Diplomën universitare të datës 25.10.2018 të ankueses me të cilin mori titullin Master i mësimdhënies së matematikës; Diplomën e datës 12.03.2012 të ankueses me të cilin mori titullin bachelor i programit matematike-informatikë; Licencën e mësimdhënies të datës 10.12.2012; Kontratën e punës të datës 01.03.2015; Autorizimin e datës 20.05.2021; Certifikatën e datës 14.12.2020 me numër B-10296406; Listën e pagave për periudhën 01.05.2021 deri me 31.05.2021; Vërtetimin e datës 07.06.2021; Kontratën e Punës të datës 24.05.2013 me numër 265/04; Licencën për mësimdhënie të datës 28.12.2015; Diplomën e datës 13.06.2012; Licencën për mësimdhënie të datës 28.12.2015; Autorizimin e datës 20.05.2021; Kontratën e punës të datës 18.12.2015 me numër 499/2015; Certifikatën e datës 18.06.2015 me numër 1152/a; Listën e pagave për periudhën kohore 01.04.2021 deri me 30.04.2021; Diplomën universitare të datës 06.04.2012 të ankuesit me të cilën mori titullin Arsimtar i Matematikes; Licencën e mësimdhënies të datës 10.12.2012; Kontratën e Punës të datës 05.09.2019 me numër 2010-2/2019; Vërtetimin e datës 27.05.2021 me numër 718; Autorizimin e datës 29.05.2021; Listën e pagave të ankuesit për periudhën kohore 01.04.2021 deri me 30.04.2021; Autorizimin e datës 31.03.2021; Vërtetimin e datës 19.03.2021; Kontratën e punës të datës 05.09.2019 me numër 2010-1/2019; Listën e pagave të ankueses për periudhën kohore 01.04.2021 deri me 30.04.2021; Kontratën e punës të datës 20.10.2019 me numër 691/2; Vërtetimin e datës 30.04.2021 me numër 220; Kontratën e punës të datës 20.10.2017 me numër 691/2; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.11.2021 me numër të protokollit 5504/2021; Përgjigjen në ankesë të datës 14.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatohet se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën A.nr.918/2021 të datës 10.11.2021, **sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Vërtetimit me numër protokollit 733/5 të datës 05.06.2020 të U.d Drejtorit të SHFMU "Muharrem Shemsedini" ka pozitën e punës mësimdhënëse pranë kësaj shkolle; ankuesi sipas Vërtetimit me numër protokollit 2813/2021 të datës 07.06.2021, ka pozitën e punës Drejtor në SHFMU "Konstatin Kristoforidhi" në Nerodime, ankuesi sipas Kontratës së Punës me numër 499/2015 të datës 18.12.2015 ka pozitën e punës Drejtor në SHFMU "Afrim Abazi", në Sherret, ankuesi sipas Kontratës së Punës me numër 2010-2/19 të datës



05.09.2019, ka pozitën e punës Drejtor në SHFMU "Riza Matoshi" në Nikadin, ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër 2010-1/19 të datës 05.09.2019, ka pozitën e punës Drejtoreshë në SHFMU "Shaban Hashani" në Ferizaj, ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër 691/2 të datës 20.10.2017, ka pozitën e punës Zëvendës Drejtor në SHM "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj.

Ankuesit përmes përfaqësueses me autorizimin, me datën 10.08.2021 kanë parashtruar kërkesë në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Ferizajt, për kompensimin e shujtave, shpenzimeve të udhëtimit si dhe licencës. Ndërsa kjo e fundit përmes shkresës më numër 07 Nr./1196 të datës 20.08.2021 ka refuzuar kërkesën e ankuesve të datës 10.08.2021 si të pa bazuar.

Ankuesit kundër përgjigjes me numër 07 Nr./1196 të datës 20.08.2021 të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Ferizajt, parashtrojnë ankesë në KPMSHCK me pretendimet ankimore që t'iu njihet e drejta e kompensimit të shujtave, shpenzimeve të udhëtimit si dhe licencës ashtu siç është përcaktuar me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë me numër 2056.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike*, ka konstatuar se zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit Para Universitar në Kosovë, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik respektivisht pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme, Zëvendës i Shkollës së Mesme dhe Mësimdhënës i Shkollës së Mesme, nuk hynë në kategorinë e nëpunësve civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve
Ihe

Bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesen se nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr. 918/2021

Ilire Mehmeti-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Jeton KOÇA


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së autorizuar Avokates
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën Ferizajt dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së;

